



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **24.11.2022** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. “UÇK”, nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria”;**
- 3. Propozimvendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës;**
- 4. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2022/2023;**
- 5. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;**
- 6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, Universitetit të Prishtinës “ Hasan Prishtina “, sipas kërkesës së Rektorit të UP- së në Prishtinë;**
- 7. Propozimvendimi për themelimin e Poliklinikës Stomatologjike Specialistike të Kryeqytetit;**
- 8. Propozimvendimi për përkrahje financiare viktimave të dhunës në familje;**
- 9. Propozimvendimi për miratimin e Rregullores për auto-taksi;**
- 10. Propozimvendimi për shfuqizimin e Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë, 01. nr. 110-288305, dt. 31.12.2014;**

11. Propozimvendimi për harmonizim të bllokut "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar sipas Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.2015;
12. Propozimvendimi për shqyrtimin e kërkesës për mbështetje nga Kuvendi i Kryeqytetit, të propozimit "Lulëkuqja me katër petale", të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë;
13. Propozimvendimi për lirim të të gjithë personave fizikë dhe juridikë nga obligimi për tarifën në transaksion të pronës, të përcaktuara sipas Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011, dhe Rregullores 01-431/04-0253431/17 (KPR), për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-246029/22, më 09.11.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

